

VENDIM
Nr.847, datë 11.6.2008

**PËR MIRATIMIN E NORMËS SË USHQIMIT TË EFEKTIVIT GARDIST TË GARDËS
SË REPUBLIKËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të shkronjës “g” të pikës 2 të nenit 39 të ligjit nr.8869, datë 22.5.2003 “Për Gardën e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Efektivi gardist i Gardës së Republikës të trajtohet me normën ditore të ushqimit, të përcaktuar në lidhjen nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Efekti financiar, që rrjedh nga zbatimi i këtij vendimi, në shumën 231 000 (dyqind e tridhjetë e një mijë) lekë, për racion ditor, të përballohet nga buxheti i vitit 2008, miratuar për Gardën e Republikës së Shqipërisë.

3. Vendimi nr.394, datë 12.8.1999 i Këshillit të Ministrave “Për miratimin e normës së ushqimit të efektivit ushtar të Gardës së Republikës”, shfuqizohet.

4. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe Garda e Republikës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Lidhja nr.1

NORMA E USHQIMIT PËR EFEKTIVIN GARDIST TË GARDËS SË REPUBLIKËS

Nr	Artikulli	Njësia e matjes	Sasia
1.	Bukë	gr.	600
2.	Oriz	gr.	70
3.	Makarona	gr.	70
4.	Fasule	gr.	70
5.	Mish viçi i freskët	gr.	190
6.	Vaj gatim	ml.	30
7.	Vaj (ulliri)	ml.	10
8.	Gjalpë	gr.	30
9.	Sheqer	gr.	50
10.	Djathë i bardhë	gr.	40
11.	Qumësht	ml.	300
12.	Vezë	kokrra	1
13.	Perime për gatim	gr.	350
14.	Perime për sallatë	gr.	150
15.	Fruta të freskëta	gr.	250
16.	Reçel	gr.	30
17.	Salcë	gr.	3
18.	Çaj mali	gr.	1
19.	Kripë	gr.	10

